



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T. "Orange Net"  
Nr. i biznesit - 70243024  
Drejtor – Elhami HAZIRI  
Pronar  
Elhami HAZIRI  
Rr/ 15 Qershori 99, Nr.64  
Gjilan

"Orange Net" L.L.C.  
Nr. i biznesit - 810055815  
Drejtor – Elhami HAZIRI  
Pronar  
Elhami HAZIRI & Avni HAZIRI  
Rr/ 15 Qershori 99, Nr.64  
Gjilan

Ref:1710/1215/LIC/ni

**VENDIM**

*për ndryshimin e licencës të operatorit të shpërndarjes NT Orange Net nga biznesi N.T. "Orange Net" në "Orange Net" L.L.C.*

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. NT Orange Net është Operatorë i Shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në pajtim me Rregullorën KPM – 2016/01, me seli në Gjilan. NT Orange Net është pajisur me licencë të KPM-së më datën 30 tetor 2013.
3. Më datën 20 shtator 2017, pronari i NT Orange Net, ka dorzuar një kërkesë në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka kërkuar ndryshimin dhe bartjen e licencës së Operatorit të Shpërndarjes NT Orange Net, nga Biznesi Individual N.T. "Orange Net" me numër të biznesit 70243024, në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar "Orange Net" L.L.C. me numër të biznesit 810055815.
4. Gjithashtu, me anë të kërkesës është deklaruar se pjesë e biznesit "Orange Net" L.L.C. do të jetë edhe z. Avni Haziri, në cilësinë e aksionarit.

### Arsyetimi


5. Pronari i operatorit të shpërndarjes NT Orange Net ka theksuar se, arsyeja e parashtimit të kërkesës për ndryshim të licencës ka të bëjë me ndryshimin e llojit të biznesit, duke kaluar nga Biznesi Individual në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (L.L.C).
6. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
7. Komisioni konstaton se, pala e interesuar ka dorzuar dokumentet dhe informacionet e nevojshme lidhur me kërkesën për ndryshimin e licencës. Gjthashtu, Parashtruesi i kërkesës ka kryer edhe pagesën e tarifës administrative për ndryshime në licencë, në vlerë prej njëqind (100) eurove, në pajtueshmeri me Rregulloren për Tarifën Vjetore të Licencës (KPM -2017/03).
8. Komisioni e konsideron se, kërkesa për ndryshimin e licencës është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe poashtu, arsyetimin për këtë ndryshim e konsideron si të mjaftueshëm dhe si e tillë, kërkesa i plotëson kushtet për miratim.

### Vendim

9. Komisioni, në takimin e mabjur më datën 1 nëntor 2017, merr vendim, me anë të cilit miraton kërkesën për ndryshimin e licencës së operatorit të shpërndarjes N.T. Orange Net, nga Biznesi Individual me numër të biznesit 70243024, në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar “Orange Net” L.L.C. me numër të biznesit 810055815.

### Lëshimi i Vendimit

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



08.11.2017

datë